

RAZI BRAHIMI

SKËNDERBEU NË LETËRSINË E RILINDJES KOMBËTARE

I

Epoka e Skënderbeut dhe figura e kryetrimt tonë kanë qenë një nga burimet kryesore të frymëzimit dhe një prej motiveve më të dashura për shkrimtarët patriotë të Rilindjes kombëtare. Një gjë e tillë është shprehje e së vërtetës, që çdo epokë historike pasonjëse merr nga epokat pararendëse ato elemente, që përkojnë plotësisht ose në një masë me rëndësi me realitetin, idealet dhe detyrat që shtron para vetes një komb a një klasë shoqërore.

Populli shqiptar nga gjysma e shekullit XIX, që merret edhe si fillim i letërsisë së Rilindjes kombëtare, në vazhdim të përpjekjeve e të luftrave të pandërprera, ende nuk e kishte zgjidhur problemin më jetik të qenjes së vet kombëtare: çlirimin nga zgjedha e huaj, që rëndonte mbi shpinën e tij që pas vdekjes së Skënderbeut. Prandaj është e natyrshme që të gjithë shkrimtarët patriotë të ekzaltinin në veprat e tyre kohën dhe figurën e Skënderbeut, epokën e manifestimit të fuqishëm të shpirtit e të qëndresës shqiptare, kohën e lirisë e të luftës ngadhënjimtare për liri.

Dhe jo vetëm kaq. Si atëhere edhe në periudhën e Rilindjes kombëtare, sado që kishin kaluar shekuj dhe, domosdo, kishin ngjarë edhe ndryshime, armiku kish mbetur i njëjtë — pushtonjësi turk dhe rendi shoqëror po ai — sistemi feudal, që u mbajt aq gjatë më këmbë prej frenimit që i bënin zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit pushtonjësit. Kjo është një tjetër arsye e rëndësishme historike, që e bën kohën dhe figurën e Skënderbeut një objekt interesimi të përhershëm e gati të përgjithshëm për letrarët e Rilindjes kombëtare.

Për popullin shqiptar figura e Skënderbeut ishte mishërimi i madhërishtëm i virtyeteve të larta të popullit dhe shprehëse e ndjejës dhe e krenarisë kombëtare, që morën hov të ri në fund të shekullit XIX e, sidomos, pas Lidhjes së Prizrenit, që shërbeu si nxitje me rëndësi, pikërisht se ishte pasojë e drejtpërdrejtë e përpjekjeve dhe aspiratave popullore.

Është koha kur shovinistët fqinj dhe përfaqësonjësit e shteteve të mëdha imperialiste, për të mbështetur lakmitë e tyre ekspansioniste, mundoheshin t'i mohonin kombësinë popullit shqiptar duke u orvatur të fshehin të kaluarën e tij të lashtë dhe traditat e lavdishme. Shkrimtarët e Rilindjes kombëtare ju përgjegjën këtyre pretendimeve sa absurde aq edhe të rrezikshme duke hymnizuar me tërë madhësitinë e vet të kaluarën shqiptare dhe më të lavdishmen kohë

të kësaj së kaluare — kohën e Skënderbeut, e cila ndizte në zemrën e popullit ndjenjën e atdhedashurisë dhe i jepte flakë luftrave të pandërprera për liri.

Krahas këtyre do patur parasysh që edhe pa letërsinë e shkruar, figura e Skënderbeut, si rezultat i dashurisë për liri dhe i ndjenjës së vetruajtjes kombëtare, ishte e gjallë në popull dhe prandaj do të ushtronte një ndikim të madh dhe si figurë letrare. Në këtë kumesë figura e Skënderbeut e realizuar në veprat e shkrimtarëve të Rilindjes, do të trajtohet jo aq nga pikëpamja artistike, sa nga pikëpamja e interesit që ngjall ajo si një pasqyrim i së vërtetës historike dhe i idealeve popullore të kohës kur u krijua. Jeronim de Rada, Gavril Dara, Zef Serembe, Sami Frashëri, Naim Frashëri, Vaso Pasha, Anton Zako — Çajupi, Zef Skiroi, Ndre Mjeda, Ndoc Nikaj, Zef Jubani, Asdreni, Hil Mosi e shumë të tjerë kanë trajtuar në veprat e tyre motive nga koha e Skënderbeut, sa mund të themi se ekziston edhe në gjuhën tonë një letërsi e tërë kushtuar figurës e bëmave të kryetrimt shqiptar të shekullit XV.

II

Është e natyrshme dhe e kuptueshme që figura historike e Skënderbeut në trajtimin letrar t'u nënshtrohej idealeve dhe kërkesave të kohës, duke zbuluar tek ajo, në radhë të parë, ato karakteristika e veçori, që viheshin më drejtpërdrejt në shërbim të aktualitetit politik e shoqëror. Një gjë e tillë vërehet jo vetëm në vepra me motive të përcaktuara e konkrete, po edhe në veprat më të përgjithshme, në ato që synojnë të japin të gjitha anët e jetës e të figurës së heroit, siç është «Histori e Skënderbeut» e Naim Frashërit. Kështu e vërteta historike, faktet, motivet dhe krijimet e lindura nga koha e përpjekjeve më të mëdha të shqiptarëve kundër pushtimit turk kanë marrë në letërsinë e Rilindjes kombëtare theks të dukshëm aktual dhe janë vënë në shërbim të luftës së mëtejshme të popullit për çlirimin kombëtar dhe për realizimin e aspiratave të veta demokratike. Motivët më të njohura që janë trajtuar prej shkrimtarëve të Rilindjes, janë nxjerrë nga literatura historike, sidomos nga vepra e pavdekshme e Marin Barletit, si edhe nga Goletit e Hamza Kastriotit, qëndresën e princave të ndryshëm të lidhur me Skënderbenë dhe bëmat e tyre trimërore, vdekjen e Skënderbeut, rënjen e Krujës e të Shkodrës në dorë të turqve, mjerimin e Shqipërisë pas pushtimit të dytë turk etj. Nëpërmjet këtyre motiveve janë zbuluar prej shkrimtarëve të Rilindjes aspektet më me rëndësi të figurës së Skënderbeut e të luftrave të popullit nën udhëheqjen e tij dhe janë shkruar ato me kërkesat e kohës dhe me aktualitetin politik të Shqipërisë në gjysmën e dytë të shekullit XIX.

Jo më kot Naim Frashëri e mbaron veprën e tij «Histori e Skënderbeut» me këto fjalë: **Skënderbeu është i gjallë, — rron e mbretëron**

për jetë, — kjo fjalë s'është përrallë, — ndaj t'urtit është e vërtetë. — që duan të thonë se Skënderbeu edhe pas vdekjes nuk ishte vetëm krenari për Shqipërinë e për shqiptarët, po vazhdonte t'u jepte atyre dritë dhe t'u rrëfente rrugën e shpëtimit, rrugën e bashkimit e të luftës pa kompromis me shkelësit e vendit. Dhe, kur flasim për letërsi artistike, ky është aspekti më i rëndësishëm që duhet të na tërheqë vëmendjen, prandaj edhe do të ndalemi më tepër pikërisht tek trajtimi i figurës së Skënderbeut prej shkrimtarëve në funksion të realitetit të kohës dhe të idealeve popullore të kohës, kur u shkrua vepra.

Skënderbeu u ka shërbyer shkrimtarëve të Rilindjes si **mishërim i idealit patriotik** në funksion të zgjimit të ndërgjegjes kombëtare e të luftës për liri; **si mishërim i idealit të unitetit kombëtar** që do të arrihej në luftë me copëtimin feudal; **si mishërim i idealeve demokratike** të konkretizuara në dëshirën për të patur në krye ngaherë udhëheqës popullorë, që duan popullin dhe janë të thjeshtë e të drejtë si populli; **si mishërim i virtyteve më të mira të popullit.**

Në pajtim me të vërtetën historike dhe me këto piksynime të tyre shkrimtarët e Rilindjes kombëtare i kanë tërhequr subjektet nga luftrat mbrojtëse të Skënderbeut, duke hymnizuar kështu atdhedashurinë e tij dhe përpjekjet për krijimin e konsolidimin e shtetit shqiptar. Tepër i njohur është motivi i zgjimit të vetëdijës kombëtare tek heroi kur ndodhet në oborrin e sulltanit. Naimi na e përshkruan këtë moment me pasoja shumë të rëndësishme në formën e njohur të ngritjes së «fatit të Shqipërisë, si i vdekuri nga varri», që shëmbëllet me Gjon Kastriotin dhe kërkon që Skënderbeu të zgjohet dhe të mendojë e të luftojë për mëmëdhenë. De Rada këtë moment e lidh në mënyrë shumë të natyrshme me intrigat që thur i biri i sulltanit kundër Skënderbeut dhe me dyluftimin e tij me tartarët. Në atë çast:

E ndjen trimi frymën mike, — që nga shokët po i vinte. — Por mejtoi dhe shpejt kuptoi, — që dhe dashuri e shokve, — për të do t'ishite mizore, — se dhe ata për vete e donin, — po për gjithë ishte i huaj. — Larg të gjithve krejt i varfër, — pa mburojë e ndjeu veten.

Edhe sot ne emocionohemi, kur lexojmë atë pjesë gjithë gjallëri e dritë të poemës së Naim Frashërit, në të cilën përshkruhet kthimi i Skënderbeut në Krujë: **Shqipërinë të shpëtojë, — nga zgjedhë e rëndë e Turqisë.**

Një formë tepër e efektshme, që kanë përdorur shkrimtarët e Rilindjes është të vënit ballë për ballë i kohës së Skënderbeut me gjendjen e Shqipërisë nën zgjedhën turke, pas vdekjes së tij, duke mbajtur një qëndrim që shëmbëllet si përhapje e motivit të vjershës së njohur të Pashko Vasës: «Shqypnis së robnueme». Si elemente kryesore të kësaj antiteze të madhe gjejmë: gjendjen e Shqipërisë nën Skënderbenë e paraardhësit e tij nga një anë dhe gjendjen e saj nën pushtimin turk, nga ana tjetër; Shqipërinë e Skënderbeut, në një anë dhe Turqinë e sulltanëve në anën tjetër.

Çajupi e jep kështu dallimin ndërmjet kohës së Skënderbeut dhe periudhës pas tij.

Kanë qënë trima të lëvduar — dhe në luftë s'janë turpëruar, — qenë trima dhe mëmëdhetarë, — besa, feja s'i kishin ndarë — shkonin jetën me pushkë në dorë... — lulëzonte gjithë Shqipëria, — s'e kish shkelur si sot robëria — gra e burra donin Shqipërinë, — djem e çupa këndonin lirinë.

Sot qysh gjëndet komb i Shqipërisë? — pyet Çajupi. — I përmbysur nga zgjedhë e Turqisë. — Shqipëtarët si dhe bagëtia, — çbathur, çveshur, vdesën nga uria.

Naimi vë përballë njera-tjetrës Shqipërinë e Skënderbeut dhe Turqinë e sulltanëve:

Mbretëri ishte liria, — që kish çdo shqipëtar pjesë, — ligjë ishte njerëzia — vëllazëria ishte besë.

Kjo ndër shqiptarët, kurse ndër turqit:

Mbret ndër ta është djallëzia, — nuk është kurrë e vërteta, — dhe ligj është ligësia, — edh' e rremeja e shkreta.

Në forma të ndryshme këto dallime i gjejmë të shprehura drejtpërdrejt ose nëpërmjet tabllosh nga jeta në të gjitha veprat me rëndësi që meren me kohën e luftrave të Skënderbeut dhe me pushtimin turk të Shqipërisë.

Evoda e De Radës:

E pa nëmën, që pa ndalje, — derdhej si vërshimë ujrash — përmbi Arbër. E pa vëndin, — ku pat lindur, plot me burra — të drobitur dhe gra skllave — në shtëpitë, pre t'armikut; — dhe ngado, rreth tyre, gjithë — ngrinin duart kundër tyre...

Ata shqiptarë që pak kohë më parë ishin veshur me rroba t'arta e të farkuarë me armë të ergjënda e të lara, — thotë Sami Frashëri, — ata e bijtë e tyre janë sot lakuriq, me një këmishë, që s'ka ku t'a zerë geni.

Asdreni:

Sot zëri i fortë i luanit më s'dëgjohej, — që malet i përçante si gjëmimi — por zë bretkocash posht prej pellgut çohet, si këngë zije, këngë robërimi.

Hil Mosi:

...Vajtoj dhe t'rrebtat lufta t'Skanderbegut — dhe zogjt e shqy-pes q'sot n'robni lëngojnë. — Letina, patërshana e kordha, — sot për barbarë luftojnë e jo pr' Atdhe.

Siç shihet kemi të bëjmë me një platformë të përgjithshme e të përbashkët për të gjithë shkrimtarët patriotë, një platformë që është përcaktuar nga qëndrimi i tyre ideor dhe emocional ndaj dy kohëve të ndryshme dhe nga konceptet e tyre për një mbretërim liriye dhe për sundimin feudal ushtarak turk, dy herësh të urryer: edhe si sistem në vetvete, edhe si realizonjës i robërimit kombëtar. Në të tilla rrethana e duke u nisur nga të tilla koncepte, hollësitë e humbin rëndësinë e tyre dhe në plan të parë del ajo që është më e rëndësishme, më esenciale: liria e cila është baraz me lumturinë e me bukurinë, në një anë, dhe robëria që është baraz me mjerimin dhe me shëmtimin, në anën tjetër.

Edhe përfaqësonjësit kryesorë të këtyre dy botëve — Skënderbeu dhe Sulltani — për shkrimtarët e Rilindjes janë antipodë të njëri-tjetrit dhe nuk kanë asnjë përqasie ndërmjet tyre. Skënderbeu thotë Naimi:

Ishte mbret i bukurisë, — si dielli epte dritë, — kish të gjitha mirësitë, — dhe të tërë urtësinë, — njerëzinë e dituritë — dhe fuqinë e trimërinë.

Kurse:

M'i madhi tyre, Murati, — s'kish ndër mënd kurrë të mirë... urdhëri tij: vraje, vare, — këto fjalë dijë mbreti, — hell edhe grep e lavare, ishte mbushurë qyteti...

Po lufta e popullit tonë, si në kohë të Skënderbeut edhe më vonë, ishte ndeshur në copëtimin feudal të vendit, ndaj kish qenë e mbetej detyrë historike, që krahas luftës për çlirimin nga zgjedha e huaj të hidheshin edhe themelet e një shteti të vetëm shqiptar, të forcohej **uniteti kombëtar** në luftë me separatizmin feudal dhe këshu t'i sigurohej Shqipërisë, siç dëshironin përfaqësuesit më të shquar të Rilindjes, një e ardhme sa më demokratike, e qytetëruar dhe e ndritur. Në këtë mes, për të mbështetur idealet dhe përfytyrimet e tyre, ata i kanë atribuar kohës së Skënderbeut edhe konceptet e krijuara nën ndikimin e lindjes së elementit borgjez në Shqipëri dhe të iluminizmit e të revolucionit borgjez francez tek vetë shkrimtarët. Po prapë në themel, edhe në raport me të vërtetën historike, ata nuk gjenin në të kaluarën e Shqipërisë përpjekje më të mëdha e më të frytshme se ato të Skënderbeut për krijimin e një lidhje të të gjithë principatave shqiptare nën një drejtim të vetëm duke kapërcyer gjer në një farë mase copëtimin feudal.

Shkrimtarët e Rilindjes kanë ditur edhe në këtë drejtim të kapin hallkën më kryesore në veprimtarinë e Skënderbeut: vënjen e intereseve kombëtare dhe të nevojës së bashkimit mbi interesat principatore e klasore të sundonjësve feudalë krahinorë. Nëpërmjet luftës kundër pushtonjësve të huaj do të arrihej edhe bashkimi dhe do të krijohejshin premisat e krijimit të një shteti të vetëm. Elementi që i bashkonte princat (me njëri-tjetrin) ishte lufta kundër sundimit të huaj, ndërsa elementi që i ndante ishte kujdesi i tyre për të mos humbur pasurinë, zotërimet tokësore dhe pushtetin e pavarur. Kjo tendencë separatiste ka qenë për Skënderbeun po aq e rrezikshme sa edhe vetë ushtritë e sulltanëve, që i vërsuleshin dallgë-dallgë Shqipërisë.

De Rada na paraqet skenën e fillimit të një dyluftimi nëpërmjet Nikut e Bozdarit në dasmën e Skënderbeut. Ata janë feudalë të hakërryer:

Po në çast e ëma e prijsit, — vetë zonja Voisavë, — me duar të saj dy tehat e kordhëve të tyre mbajti, — edhe dhëndëri, i biri, Gjergji, — në mes heshtejs plot nderim, — bën përpara edhe thotë: — Në mes begatisë së huaj — isha. Dhe fatin e mirë, — e shqelmoja, që Atdheut — të pafat, t'i jap një shtet, — si të gjithë e kanë. Shoqe, si prej qiellit e dërguar, — m'u duk Ora që më suall në shtëpi. Por më gënjeu, — Zotër të shtëpivet tyre, — bijt e kombit tonë sot — njëri tjetrin po e hanë.

Shkrimtarët e Rilindjes vënë përballë copëtimit feudal idealet e tyre patriotike dhe ndjenjën e thellë të ndërgjegjes kombëtare, që e gjejnë tek populli dhe, njëkohësisht, pa bërë dallime të theksuara klasore, nga një anë, ekzaltojnë bashkimin e arritur në kohën e Skënderbeut e, nga ana tjetër, damaskojnë në plan politik e patriotik pa cekur esencën ekonomike e shoqërore të çështjes, krerët tradhëtarë që u bashkuan me pushtonjësit e huaj, të nxitur nga ambicjet dhe etja për pasuri e pushtet, siç ndodh me Ballabanin, me Hamza Kastriotin dhe me Moisi Golemin. Tek De Rada, sidoqoftë, gjejmë një paraqitje më të gjerë e më konkrete të dallimeve e të ndarjeve principatore dhe, duke lexuar veprat e tij, ndryshe nga ç'ndodh kur lexojmë, bije fjala, «Histori e Skënderbeut» të Naimit, kemi një përfytyrim më konkret të gjendjes së Shqipërisë n'atë kohë dhe të Lidhjes shqiptare nën udhëheqjen e Skënderbeut. Ai sheh edhe sundimin e pasurimin feudal n'atë kohë, edhe dallimet fetare, që e theksojnë e pajtohen me

separatizmin feudal, sado që në plan të parë, si gjithë të tjerët, vë bashkimin.

Është interesant dhe mbase rasti i vetëm në letërsinë e Rilindjes rrëfimi i Gjon Kastriotit para vdekjes në poemën «Skënderbeu i pafat».

S'mjaftoi zemra që më falën, — desha edhe gjënë e tyre, — dhe kamata për të majmur — njerëzit e shtëpisë sime, — gjer dhe qent e mij dhe kuajt. ... — Tashti shkoj. E asgjë s'u jap, — për gjithë ato që u grabita. ...

U dhe të gjithve jetën tënde, — i thotë peshkopi, nëpërmjet të të cilit, në këtë rast, De Rada thekson anën patriotike të jetës së Gjon Kastriotit, të cilin e përfytyron, jo ndryshe, po si çdo sundimtar tjetër feudal sado trim e luftëtar.

Edhe përsa i takon rolit të fesë De Rada është më afër të vërtetës historike. Ndërsa shkrimtarët e tjerë shohin rolin përçarës të feve vetëm pas vdekjes së Skënderbeut dhe pushtimit të dytë turk, ai e sheh atë rol edhe më parë:

... që kur Birin e Tynzoti, — i thotë Serafina të shoqit, — e përfaqësojnë priftër — të Stambollit e të Romës, — armiq t'egër në mes tyre, — q'edhe neve na përçanë: — këndeji gegë e andej toskë. ...

Sipër këtyre ndasive feudale e fetare ngrihet madhështore figura e Skënderbeut, me autoritetin e plotë të fjalës së mënçur, të dashurisë së madhe për Shqipërinë, të shpatës së mprehtë e të krahut të fuqishëm. Ai ndeshet me Ballabanin dhe e mund, përbuz e mallkon të nipin, i jep rast të pendohet Moisi Golemit, bashkon e tratjon si shok armësh gjithë princat e gatshëm për luftë. I gjejmë këto aspekte tek De Rada, te Naimi dhe te Gavril Dara i Riu. Po në vlerësimin e përgjithshëm të kohës së Skënderbeut pothuajse të gjithë shkrimtarët theksin kryesor nuk e vënë tek dallimet e përçarjet feudale, po tek bashkimi i arritur. Kjo ka ndodhur, për dy arsye: e para, se po të mos qe arritur një bashkim i tillë, zor se mund të qëndrohej para perandorisë osmane për një çerek shekulli dhe, e dyta, se qëllimi i shkrimtarëve ishte që nëpërmjet evokimit të asaj kohe të ngjallnin edhe tek bashkëkohësit ndjenjën e bashkimit si të vetmin mjet shpëtimi nga zgjedha e huaj në një botë ku: **ndihma jonë është vetja jonë**. Me këtë sy duhen parë edhe mostheksimi i dallimeve feudale edhe mendimi se vetëm atëhere kishte «shqiptarë të vërtetë, që i qëndronin me shpatë Turqisë», dy aspekte këto, që nuk mund të pranohen nga vështrimi i rreptë i historisë, po që kanë shërbyer të dy për zgjimin e sdrës e të ndërgegjes kombëtare.

Shqiptarët kryen «... punë të shkëlqyera dhe lufta të nderuara... në kohën e Skënderbeut, — thotë Dara, — sepse vetëm atëhere për së pari dhe medet, për të fundit herë, e gjithë fisnikëria, e gjithë rinia e Arbërisë, burra dhe gra, pleq dhe të rinj, patën një zemër, duke dashur nderin dhe lirinë e atdheut që i lindi dhe ç'deshte njëri e donin të gjithë. ... Andej, nga ai bashkim i shejtë lindi fuqia, që për njëzetë e pesë vjet shkatëroi fuqit e turqve dhe përpiu njërën pas tjetrës ushtritë e Zotit të Madh, atëhere kur Evropa e përmbysur tmerrohej kur i dëgjonte emërin.

Dhe Zef Jubani:

Gjithë Zotërinjt' e Arbërisë, — dhanë dorën nën të me u shkrua, — duel i par i prini ushtërisë — Zoti t'mbarën ia dha trimnisë.

O kohë e kujtueshme përgjithmonë, — lexojmë në poemën «Te» dhe i huaj», — kur një e vetme ndjenjë e shenjtë — shkundi tërë Shqipërinë... Hieja e toskëve të parë, — si për jetë, ashtu për vdekje, — u bashkua me Skënderbeun, — kush do kush me trima t'vet... — rrokën shizë e kordha e harqe — edhe muarën prapa të zotët — për në shesh të burrërisë.

Edhe në poemën e Naim Frashërit një përfytyrim të tillë gjejmë:

Pa Skënderbeu i mblodhi, — erdh gjithë Shqipëria, — parësia me vrap rrodhi, — dhe pas gjithë vegjësia... — Parësi e Shqipërisë, — ishte bërë zjarr e flakë, — s'i trëmbeshinë Turqisë, — ndonëse ishin më pak.

Kështu shkrimtarët tanë të Rilindjes, qoftë për shkak të koncepteve të tyre që mund të përfshinin qenjen e klasave dhe, aq më pak, luftën e klasave, qoftë të shtyrë nga ndjenjat e atdhedashurisë dhe nga metoda artistike romantike që sundonte letërsinë tonë të asaj kohe, nuk dalluan mirë në periudhën e Skënderbeut dallimet dhe kundërthëniet klasore dhe nuk kuptuan se bashkimi kombëtar ishte, në radhë të parë e kryesisht, vepër e popullit punonjës, me aspiratat e të cilit bashkoheshin edhe princat liridashës. Kështu mund të themi që, ndërsa në të parë ngjan se vegjësia shkoi prapa parësisë, në të vërtetë ishte parësia që shkoi pas saj. Veç kësaj, edhe po të gjykojmë nga parafytyrimet e së ardhmes së Shqipërisë, që gjejmë tek shkrimtarët e Rilindjes, zor se mund të themi që ata e mohojnë krejt feudalizmin, me gjithë kërkesat e tyre për formë demokratike qeverimi, për futjen e qytetërimit borgjez dhe për zhvillimin e kulturës e të arësimit. Si në të kaluarën edhe në të ardhmen ata shihnin jo kundërthëniet, po më tepër «harmoninë» e gjithë shoqërisë, nën emblemën e bashkimit e të përparimit kombëtar. Vetëm nga fundi i Rilindjes, kur tradhëtia e krerëve feudalë zbuloi më mirë kontradiktat klasore, u arrit në pozitë e përparuar të Çajupit, të Mjedës e më vonë të Asdrenit e të Nolit.

Element tjetër me rëndësi për arritjen e bashkimit kombëtar për shkrimtarët e Rilindjes ishte edhe autoriteti e vetitë e larta të Skënderbeut, autoritet i fituar me luftë e me përpjekje dhe i kërkuar me kohë prej të gjithëve, të cilët e pritën kthimin e tij nga Turqia: «**duke thënë erth Skënderbeu, — erdhi vetë perëndia**» (Naimi).

Për shkrimtarët e Rilindjes kombëtare Skënderbeu ishte personifikimi i atdhëtarisë, i përsosmërisë morale dhe i harmonisë njerëzore. Gjithçka tek ai është e bukur: fytyra, trupi, mendimet, sjelljet, të bëmet. Ai është i bukur, trim, i fortë, i drejtë, i zgjuar, i ditur, i rreptë me armiqët, i dashur me popullin dhe i barabartë me shokët e luftës, njeri që mbi të gjitha vë Atdhën dhe lirinë.

Sa të jem unë në jetë, — gjithënjë për Shqipërinë, — do të lëf-toni pa të metë — thotë Skënderbeu i Naimit. Ai e ka gas e për lëndatë, të vritet për Shqipërinë, të përpigjet ditë e natë, t'i mërgonjë ligësinë.

Ai është i dashur me shokët e luftës, qofshin këta ushtarë të thjeshtë, apo princa udhëheqës. Kjo veti e tij është pasqyruar në veprën e Darës e të Naimit. Dara e paraqet Skënderbenë në tendë bashkë me shokët e armëve, që jeton si ushtar i thjeshtë, që nuk e dallon veten prej të tjerëve dhe që kujdeset, jo vetëm për luftën, po edhe për fatin e brengat e trimave të tij. Kur mer vesh brengën e Nik Petës, ai nuk ja prish qejfin atij, po e lejon të vejë për të shpëtuar të dashurën dhe e këshillon si të veprojë. Ai ndjen dhe kupton fajin dhe

pendimin e Mosis Golemit dhe, megjithëse i ngrysur e fjalëpakë më të, i jep rastin të shlyejë me vepra gabimin që ka bërë. Naimi në shumë vargje të poemës së vet e tregon Skënderbenë në mes ushtarëve të tij dhe popullit. Ai «bashkë me ta rrinte, — dhe me ta lont' e dëfren-te, — bashkë hante, bashkë pinte — dhe vetë me ta kërcente».

Është kjo një prej arësyeve që edhe ushtarë e kumandarë e donin Skënderbenë dhe ishin gati të flijonin edhe jetën e tyre për të. Ata e donin, se i donte, e nderonin, se i nderonte. Ai i bënte për vete njerëzit.

Në figurën e Skënderbeut shkrimtarët e Rilindjes kombëtare kanë parë realizimin e idealeve humaniste dhe të aspiratave popullore për një mbret popullor, të drejtë e të thjeshtë. Po ai nuk është vetëm i mirë dhe i drejtë. Ai është edhe i fortë. Aq sa gëzohen shqiptarët kur dëgjojnë emrin e tij e kur ndodhen pranë mbretit, aq tmerrrohen armiqët kur dëgjojnë se vjen Skënderbeu. Këtë fuqi të Skënderbeut shkrimtarët e Rilindjes e kanë ngritur në legjendë dhe i kanë ngjitur attribute legjendare duke pretenduar se «në krah të djalhtë, ku kish lindur, kishte një shenjë si shpatë» (Naimi), apo se «ish trimi lindur dragua» (De Rada).

Ja një episod lufte i përshkruar nga Naimi:

Skënderbeu si astriti, — u hodh mbi ta si fajkua, — nga' armikët njeri s'e priti, — se e kishënë dëgjuar, — gjithë bota Skënderbenë, — papo duke tëmeruar — të gjithë muarë dhenë. — Larashi me vrap kur bije, — qysh marrin zoq' arratinë?.. — ashtu dhe atyre mbreti, — u dha tmerrë me një herë, — pa në sheshtë as një më s'gjeti, — kë të zer' e kujt t'i bjerë.

Këto veti të larta dhe jo pushteti i japin Skënderbeut autoritet të plotë para bashkëluftëtarëve të tij trima dhe e bëjnë të fortë si para armiqve të huaj edhe para tradhëtive dhe përcarjeve feudale, duke e lartësuar në nivelin e një udhëheqësi të të gjithë Shqipërisë dhe të një kapedani me nam të përbotshëm.

Në mënyrë sintetike gjithë vetitë e kryetrimt tonë i paraqet kë-shtu Sami Frashëri: Atij «istoria s'i tregon nonjë shok a shëmbëlli në trimërit, në diturit të luftës, në forcët si dhe në dijet, në mendimt të drejtë, në njerëzit, në ëmbëlsit të zëmërës e në madhërit të shpirtit.

Një tejtër aspekt me rëndësi që ka tërhequr vëmendjen e shkrimtarëve të Rilindjes është edhe raporti që u krijua në atë kohë ndër-mejt Shqipërisë dhe Evropës, qëndresës së popullit tonë të vogël e të vetëm kundrejt perandorisë së madhe otomane, roli i luftës së popullit tonë për shpëtimin e qytetërimit evropian dhe besimi i një grushti shqiptarësh në forcën e tyre, në të vetmen forcë ku mund të mbështeteshin dhe u mbështetën.

Kush i qëndronte Turqisë, — q' ishte posi mizëria, — veç trimat e Shqipërisë, — që s'i mundte dot Turqia, — thotë Naimi, ndërsa sull-tanit i vë në gojë fjalë të tilla:

Të mos ishte Shqipëria, — që më pret udhënë mua, — sot e tërë njerëzia do t' ishte imja pothua. — Kisha marë Italinë, — edhe Evropënë të tërë, — Ungarin' e Gjermaninë, — e kush e di ç'kisha bërë.

Dhe kjo nuk është fantazi poetike. Pas vdekjes së Skënderbeut dhe rënjes së kështjellës shqiptare që priste mbi vete rrebeshet e Anadolit, Turqia, megjithëse jo më në lulëzimin e fuqisë së vet ushtarake, arriti në portat e Vjenës.

Kështu Shqipëria dhe Skënderbeu i kryen detyrat e tyre me nder para qytetërimin evropian dhe lirisë së popujve të Evropës. Po shtetet e Evropës ç'qëndrim mbajtën ndaj mbrojtësve të tyre?

Me Turqin' e me Serbinë — e kish prishur Skënderbeu, — s'doj ta prishë me Venedinë, — papo puna s'i pëlqeu. — Po domosdo do ta prishte, — se vu këmbë Venetija, — puna rezik të madh grishte, — kish dëm shumë Shqipëria. se Skënderbeu thotë:

Kush kërkon miqësinë, — nesh atë po do ta gjenjë, — ndryshe kurrrë Shqipërinë — me lajka s'munt ta gënjenjë...

Edhe De Rada të tillë e ka paraqitur gjendjen dhe e ka shprehur, nëpërmjet Radavanit mendimin e madh: ndihma jonë është vetja jonë.

... Ndaj mesnate — Radavani i ngjoi e u thotë: Ne nuk kemi se ç'të presim. — Djemtë tanë këtu janë: kurse latinët tejdetit — dhe mbreti grek i Bizancit — as e çajnë kokën për ne. Ndhima jonë është vetja jonë. Në sulm, shokë, këtë orë, — që na lanë Zot e njerëz.

Dhe populli i vete gjithnjë pas Skënderbeut dhe trimave të tij, duke mbajtur edhe atëhere me një dorë parmendën e kërrabën e me tjetrën shpatën dhe shigjetën.

«Hej, — u thërret Radavani barinjve, — po ikni, o t'arbreshë? — Me kësulatë në dorë, — ata ju gjegjën: Jo, zot, — Sapo të strehojmë grigjët, edhe të na jepni armët, — dhe na ke pas ku të duash, — Kështu thanë. Trimat rodhën — armëngjeshur nga Janina — ku qe mbledhja.

Në letërsinë e Rilindjes kombëtare kampet kundërshtarë vihen për ballë njëri-tjetrit, jo vetëm në plan politik e ushtarak, po edhe në plan kulturale e shoqëror dhe në çdo plan që vihen ballë njëri-tjetrit, jo vetëm për arsye sentimentale, po edhe në pajtim me të vërtetën historike. Shqipëria qëndron kurdoherë më lart dhe përfaqëson lirinë, kulturën, begatinë, bukurinë. Sado që në këtë mes gjen vend disa herë edhe një idealizëm naiv, në themel përfytyrimi i shkrimtarëve të Rilindjes mbështetet në disa të dhëna të njohura historike: se Shqipëria para pushtimit turk, ishte një vend relativisht më i përparuar nga Turqia dhe prirëj drejt një shkalle më të lartë qytetërimi, se pushtojnësit turq deshën të imponohen dhe u imponuan për një kohë të gjatë edhe duke shkatërruar kulturën materiale dhe qytetërimin e dikurshëm shqiptar, se sistemi shoqëror në Shqipëri, megjithëse feudal, nuk kishte marrë ato forma të egra dhe obskurantiste, që kishte marrë feudalizmi ushtarak turk, i veshur me petkun e fetarizmit fanatik dhe të injorancës. Pra, donin një Shqipëri të çliruar nga zgjedha turke, po e donin këtë Shqipëri edhe të qytetëruar e të qeverisur me drejtësi. Për ta, siç u shpreh Naimi, atëhere drita vinte «**andej nga perëndon**», dmth. të pushtuar e të ndrydhur nga feudalizmi ushtarak turk dhe nga obskurantizmi fetar mysliman, ata i kishin kthyer sytë nga Evropa që përfaqësonte shkallën më të lartë të zhvillimit shoqëror të asaj kohe.

Ndërsa sulltanët e Turqisë janë «**egërsira si ariu, me fytyrë si njeriu**», që mburren se «**prishën, vranë, prenë e therrën**» (Çajupi). Skënderbeu do trimërinë dhe i falet burrërisë, po do edhe njerëzinë (Naimi).

Naimi kurdoherë, si me kast, ka vënë pranë trimërisë edhe njerëzinë, mirësinë dhe diturinë. Sipas tij, Gjon Kastrioti, kur përcollti të bijtë për në oborrin e sulltanit, u dha këtë porosi:

U thotë të silli mirë, — të bëni njerëz në jetë, — të mos mbetni n'errësirë, — po të jini të vërtetë, — natë e ditë të këndonj, — ç'do q'u duhet t'a dini, — gjithë gjuhët t'i mësoni, po shqipenë mos e lini, — mirësitë e Shqipërisë, — i mbani mos i harroni... — Se.

Atyre që mbretërojnë, — e mbretër të mirë quhen, — u duhet njerëzia, — zotëria e të tjera, — mirësia, trimëria, — gjithë vetitja e vlera...

Për Naimin dhe për gjithë shkrimtarët e Rilindjes ka rëndësi në radhë të parë njeriu, pastaj mbreti, se vetëm i miri dhe i dituri mund të mbretërojnë, siç duan ata, me drejtësi e me njerëzi dhe vetëm atij do t'i vejë pas gjithë populli. Në këto koncepte kemi një ndërthurje origjinale të humanizmit e të iluminizmit evropjan me ligjet dhe pikëpamjet e fiseve të lira shqiptare të kohës.

III

Motivet e trajtuara në veprat e shkrimtarëve të Rilindjes kombëtare janë më të shumta dhe shumë prej krijimeve të poetëve tanë nuk zunë vend e nuk mundëm t'i analizojmë në këtë kumtesë, që pati si pikësypnim të ravijëzojë tiparet dhe veçoritë kryesore të trajtimit të temave të nxjerra nga koha e Skënderbeut dhe qëndrimet e mbajtura ndaj heroit kombëtar prej shkrimtarëve të asaj kohe. Duke pranuar qortimet që mund të bëhen për mungesat, dëshirojmë të ndalemi në disa shënime të fundit e në disa përfundime lidhur me trajtimin e figurës së Skënderbeut në letërsinë e Rilindjes sonë, për të cilën, siç thamë, ajo ka qenë një prej burimeve kryesore të frymëzimit e një prej motiveve të dashura dhe është vënë në shërbim të lëvizjes çlirimtare të popullit. Në këtë mënyrë, shkrimtarët e Rilindjes ndihmuan që Skënderbeu, edhe pas vdekjes, për shekuj me radhë të marrë pjesë në luftat e popullit të vet dhe t'u japë bashkatdhetarëve **dritë nga shpirti i ndritur i tija**, t'u mbajë gjallë besimin se **si vogëli mund viganin dhe i dobëti tiranin**, t'u bëjë thirrje për bashkim kombëtar dhe t'u shtojë qëndresën në betejat e shekullit të fundit kundër robërisë turke. Ata e përdorën figurën e Skënderbeut edhe për realizimin e mendimeve të tyre iluministe e demokratike dhe, në këtë mënyrë, pavarësisht nga saktësia historike e aisa hollësive e qëndrimeve, hero i ynë u trajtua, jo si një shtatore e gurtë dhe e palëvizshme, po si një fenomen i gjallë, që ecën bashkë me kohën, bashkë me popullin, duke rendur nëpër shekuj faqendritur, si një element i ndërjegjës kombëtare të shqiptarëve. Veprat e De Radës, Darës dhe Naimit me shokë ishin një kontribut i çnuar për njohjen e Skënderbeut nga masat e popullit dhe edukuan me ndjenjat e patriotizmit të kulluar e të krenarisë kombëtare shumë breza të rinisë sonë. Ato edhe sot lexohen me ëndje e me dobi të madhe, megjithëse materialet historike që janë vënë në themel të tyre, me përjashtime të rralla, duket se kanë qenë të kufizuara dhe jo kurdoherë dokumentare. Pjesa më e mirë e shkrimtarëve ngjan të ketë përdorur si udhërrëfënës veprën e pamort të Barletit.

Me një gjerësi më të madhe motivesh është trajtuar koha e Skënderbeut në letërsinë arbëreshe, në veprat e De Radës, të Darës etj. Në këto vepra ka më tepër gjerësi në trajtimin shoqëror të temave, më tepër liri letrare dhe më tërthoras ka dalë figura e vetë Skënderbeut. Në to shihet edhe tradita e këngës popullore, që u për-

tëri ose lindi më vonë në terrenin arbëresh. Kjo këngë la fare pak gjurmë në Shqipërinë e pushtuar dhe në shekullin XIX ishte pothuajse e padukur në botime e përmbledhje. Do patur parasysh në vlerësimin e këtij dallimi edhe fakti që poema e Naim Frashërit ka një subjekt linear, me pretendimin kryesor t'i qëndrojë sa më afër të vërtetës historike dhe t'u japë shqipëtarëve një vepër historiko-letrare për figurën e madhërisme të kryetrimt. Pra kemi pikënisje të ndryshme dhe, domosdo, edhe rezultate letrare të ndryshme, në të cilat kanë ndikuar edhe personalitetet e dy shkrimtarëve tanë të mëdhej.

Një tjetër dallim ndërmjet pjesës arbëreshe dhe të këtejme të letërsisë së Rilindjes kombëtare është edhe se letërsia e këtejme ka qenë më e drejtpërdrejtë, më në funksion imediat të luftimeve për liri dhe të programeve politike të lëvizjes çlirimtare. Edhe ky dallim është i kuptueshëm gjersa autorët e këtyre veprave kanë qenë të lidhur drejtpërdrejt dhe disa herë, edhe kanë kryesuar lëvizjen çlirimtare brënda dhe jashtë Shqipërisë. Ndaj është e natyrshme që Skënderbenë ata ta shihnin më parë si luftëtarë, pastaj si shkrimtarë, jo vetëm si objekt krenarie kombëtare, po sidomos, si flamur lufte.

Në letërsinë e Rilindjes Skënderbeu është edhe figurë historike që u përmbahet në vijat më kryesore të vërtetave të njohura, edhe figurë letrare — shprehëse e pikëpamjeve dhe idealeve të vetë shkrimtarëve. Kjo është e natyrshme, mbasi asnjëherë nuk ka patur letërsi artistike serioze, që të mos e ketë trajtuar historinë dhe personin historik në pajtim me kohën kur është krijuar duke marrë prej historisë ato momente, që i shërbejnë më tepër kohës dhe qëllimeve të shoqërisë a të klasës që përfaqëson shkrimtari dhe duke i spjeguar dhe interpretuar ato nga pozitat ideologjike të tij. Këtij ligji do t'i nënshtroheshin edhe Skënderbeu e letërsia jonë e Rilindjes.

Nëpërmjet këtyre dy anëve nuk gjejmë ndonjë kundërtënie gjersa mjeti — idealizimi i heroit dhe i epokës — është në pajtim me escencën historike të epokës dhe me prirjen objektive të zhvillimit të periudhave historike pasardhëse. Doemos, ka në idealizimin e epokës dhe të figurës së Skënderbeut edhe hiperbolizime, edhe elemente naive. Kohën e Skënderbeut, për shembull, Naimi e karakterizon kështu: **Në vise të Shqipërisë, — s'kish gjë përveç mirësisë, moskamja dhe varfëria, — dhe të tjera të këqija, — kurrë në Shqipëri s'ishin, — mase edhe emërë nuk kishin, — s'kishin as kurva as kurvarë, — as të liq as kusarë... — secili fort mirë shkonte, — haj, pij dhe i tepronë.**

Kemi të bëjmë këtu me një qëndrim të njohur të letërsisë romantike ndaj të kaluarës. Po, në rastin tonë, në këtë idealizim, përveç naivitetit që është i dukshëm, themi se kanë më tepër rëndësi shkaqet shoqërore dhe politike që e kanë nxitur, megjithëse nuk e përligjin. Dhe këto shkaqe janë kryesisht dy:

E para, epoka e Skënderbeut ishte epoka e lirisë dhe përballë robërisë ajo që një kohë e shkëlqyer, e cila vetëm në të atillë mënyrë mendohej se mund të trajtohet, ashtu me çdo gjë të bukur dhe me çdo kohë të dashur për njerinë.

Si shkak të dytë mund të përmendim qëllimin e shkrimtarëve të Rilindjes për të luftuar të këqijat e kohës, të cilat ja mohonin epokës skënderbejane me qëllim ndikimi më të fortë tek lexonjësit. Ndaj

themi se «mëkati» i idealizimit, disa herë naiv, ka më pak e shumë më pak rëndësi se do bija e tij në atë kohë. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për qëndrimin e shkrimatrëve të Rilindjes ndaj gjithë të kaluarës sonë të lashtë.

Po, megjithëse figura dhe koha e Skënderbeut kanë qenë burim kryesor frymëzimi për letërsinë e Rilindjes, veprat e mëdha kushtuar asaj dhe sidomos drejtpërdrejt figurës së Skënderbeut janë të pakta. Përveç poemës së Naim Frashërit dhe ndonjë veprë tjetër pa rëndësi e të panjohur (kujtojmë: «**Burri i dheut**» të Çajupit, «**Skënderbeu**» të Skiroit, «**Shpata e Skënderbeut në Dibrën e poshtme**» të Bilotës), në letërsinë e Rilindjes mungojnë veprat e gjata që do të merrnin me zbulimin e madhështisë skënderbejane ose me anë nga më të rëndësishmet e saj. Edhe për epokën e Skënderbeut veprat nuk janë të shumta, megjithëse ndërmjet të paktave ka kryevepra të letërsisë sonë kombëtare, siç janë poemat e Radës e të Darës. Në përgjithësi koha dhe figura e Skënderbeut janë trajtuar në vjersha të shkurtëra, me motive krenarie apo edhe me ndonjë episod të marë nga historia e nga gojëdhanat. Proza njih vetëm romanin «**Bukurusha**» të Ndoc Nikajt, me subjekt nga periudha fill pas vdekjes së heroit dhe dramaturgjia vetëm veprën e Çajupit, e cila, fatkeqësisht, nuk i qëndron as kritikës historike letrare. Prej kësaj mund të nxjerrim përfundimin, se letërsisë sonë i mbetet akoma si një detyrë e madhe patriotike që të trajtojë më gjërësisht figurën dhe kohën e Skënderbeut. Shenjat tregojnë se vepra të tilla do të kemi. Ky jubile do ta pasurojë bibliotekën shqiptare kushtuar Skënderbeut dhe ne, siç thoshte Noli, do të këndojmë më me zjarr «**hymne lëvdatore për kryetrimin**» në këto kohë vrulli revolucionar dhe vigjilence për të mbrojtur lirinë e atdheut dhe fitoret e revolucionit.

R é s u m é

SKANDERBEG DANS LA LITTÉRATURE DE LA RENAISSANCE NATIONALE ALBANAISE

Après avoir mis en vue le fait que l'époque et la figure de Skanderbeg ont représenté une des principales sources d'inspiration pour les écrivains patriotes de la Renaissance albanaise, l'auteur Brahimi s'arrête sur les causes qui ont déterminé ce phénomène. Les représentants de la Renaissance albanaise ont évoqué dans leurs oeuvres l'époque et la figure de Skanderbeg en fonction de l'actualité, afin de servir à la réalisation des tâches urgentes que posait l'instant historique. L'époque des batailles légendaires des Albanais au XV^e siècle, — représentait le meilleur moyen dans la main les littérateurs de la Renaissance albanaise à faire ressusciter la conscience nationale du peuple albanais, qui souffrait depuis cinq cents ans sous le joug. Evoquant cette époque, les représentants de la Renaissance ont inspiré à la population la confiance dans la victoire, contre un ennemi barbare et très supérieur en nombre. D'autre part, étant une figure vivante parmi le peuple, Skanderbeg ne pouvait ne pas exercer une grande influence comme figure littéraire.

Abordant la question comment la figure et l'époque de Skanderbeg ont été soumises, dans le traitement littéraire, aux idéaux et aux révédi-

cations du mouvement de libération nationale, Brahimi fait observer que les auteurs de la Renaissance albanaise ont saisi et mis en lumière ces particularités qui desservent directement l'actualité politique et sociale. Skanderbeg a servi aux représentants de la Renaissance albanaise en tant qu'incarnation de l'idéal patriotique, en fonction du raffermissement de la conscience nationale, de l'unité nationale, des idéaux démocratiques et des meilleures vertus du peuple.

Dans l'Histoire de Skanderbeg de N. Frashëri ont trouvé leur reflet précisément ces instants de la vie de Skanderbeg que nous venons de mentionner, comme le réveil de la conscience nationale chez le héros (chant V) ou son retour dans le pays, qui témoigne précisément du profond attachement à sa Patrie de la part de notre peuple. L'instant touchant de son retour dans le pays a été reflété aussi dans l'oeuvre de de Rada.

C'est en mettant face à face l'époque de Skanderbeg et la situation de l'Albanie sous le jour turc, après sa mort, que N. Frashëri, S. Frashëri, A.Z. Çajupi, de Rada, Asdren, et d'autres, idéalisent cette époque dans leur productions, la considérant le règne de la liberté et de l'harmonie.

C'est afin de servir à la consolidation nationale, que nos représentants de la Renaissance ont pris le principal maillon de l'histoire de Skanderbeg: la mise des intérêts nationaux et du besoin d'union au dessus des particularismes féodaux et de classe des feudataires régionaux. Dans les productions de Naim Frashëri ou de de Rada on assiste, d'une part, à l'exaltation de l'union obtenue aux temps de Skanderbeg, et, d'autre part, sur le plan politique et patriotique, on démasque les chefs de la trahison qui sont allés rejoindre les étrangers. Les représentants de la Renaissance, soit en raison de leurs concepts, soit portés par le sentiment de rattachement au terroir, ou bien encore en raison de la méthode romantique, n'ont pas mis une ligne de démarcation bien nette aux divisions de classe dans la période de Skanderbeg, ils ont exalté «l'harmonie» de toute la société. Aussi dans leurs représentations sur l'avenir de l'Albanie, malgré leurs revendications sur des formes démocratiques de gouvernement, les littérateurs de la renaissance ne niaient pas complètement la féodalité. Ce ne fut que vers la fin de la Renaissance, alors que la trahison des feudataires mit au jour parfaitement les contradictions de classe, qu'on est arrivé aux positions avancées de Çajupi, Mjeda, et, plus tard, d'Asdren et de F.S. Noli.

Les écrivains de la Renaissance albanaise ont insisté, dans leurs productions, sur un facteur essentiel pour l'obtention de l'union nationale, sur l'autorité et les hautes vertus de Skanderbeg, représenté comme la personnification du patriotisme, de la perfection morale et de l'harmonie humaine, du guide populaire, preux et sage, beau et intelligent, cher pour le peuple et rude contre l'ennemi.

Un autre aspect intéressant qui a attiré l'attention des écrivains de la Renaissance albanaise est aussi celui qui se rapporte aux batailles de Skanderbeg pour le salut de la civilisation européenne, ainsi que sur l'attitude sournoise de maint pays, qui ont trouvé leur reflet dans les productions de N. Frashëri, J. de Rada, et d'autres.

Les productions des représentants éminents de la Renaissance albanaise: Naim Frashëri, J. de Rada, G. Dara, A.Z. Çajupi, et autres, qui ont évoqué l'époque et la figure de Skanderbeg, ont servi non seulement à faire connaître aux masses populaires la glorieuse tradition des ancêtres, mais aussi à faire renaître le sentiment de patriotisme et à engager toute la population dans la lutte pour la liberté.

